**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS**
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

GJAKOVA

**Njësia e Prokurimit**

Gjakovë, datë 21.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.07.2026 të parashtruar nga Operatori Ekonomik " Berisha Com " SH.P.K. , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore “, Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik “Berisha Com” sh.p.k.., e dt.17.07.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore “, Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 03.07.2025, dhe Sqarimet shtesë të dt.09.07.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të publikuar me datë: 03.07.2025 dhe Sqarimet shtesë të dt.09.07.2026;**

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori ekonomik "Berisha Com" sh.p.k. me dt.17.07.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi-rregullimi i rrugëve fushore ", Nr. i prokurimit- 632-26-4955-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-26-033-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 21.07.2026, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë të pa bazuara, sepse se të gjitha këto mjete në listën për pajisje për këtë aktivitet te prokurimit, janë të nevojshme duke pas parasysh natyrën e punës dhe terrenin ku do te kryhet punimet sipas përshkrimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqeseëankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;